



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010 dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Kryeqytetit,

th ë r r e t

mbledhjen e **tetë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **26.9.2025** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr.37 (kati II), të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore pa pagesë për punëtorët e Komunës së Prishtinës - Kryeqytetit në Qendrat e shërbimeve shëndetësore të kryeqytetit;
3. Propozim-vendimi për shfrytëzimin e transportit rrugor urban pa pagesë për punëtorët e administratës të Komunës së Prishtinës-Kryeqytetit;
4. Propozim-vendimi për emërtimin dhe rifreskimin e listës rezervë të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Prishtinës;
5. Propozim-vendimi për shlyerjen e borxhit të kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” SHA, ndaj Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK-së);
6. Raport nga komisioni për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Prishtinës;
7. Propozim-vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
8. Propozim-vendimi për bartje të 45 normave nga cikli i mesëm i lartë në ciklin parafillor dhe fillor;
9. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-142000/25, më 16.9.2025

KRYESUESI I KOMITETIT
Fehmi Kupina

